

LIGJI Nr. 03/L-042

I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të rregullimit ligjor të vendosjes në treg të substancave aktive, autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe qarkullimin dhe përdorimin e tyre,

Miraton

LIGJ I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Ligji është rregullimi i vendosjes në treg dhe kontrollimi i substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimi, qarkullimi, përdorimi, mbetjet në bimë dhe produkte bimore, mbajtjen e regjistrit dhe regjistrin e personave fizik dhe juridik të përfshira për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, kërkesat teknike për pajisjet që përdoren për aplikim dhe elementëve të tyre, përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe monitorimin e tij.
2. Ky Ligj rregullon klasifikimin, ambalazhimin, dhe etiketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në pajtueshmëri me Direktivat e Komisionit Evropian.
3. Ky Ligj rregullon mbetjet e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, mbeturinat e paketimit të tyre dhe mënyra e emetimit në mjedis .

Neni 2 Përkufizimet

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë domethënie:

“Produktet për mbrojtjen e bimëve” PMB nënkupton format e përgatitura përfundimtare të substancave aktive dhe preparateve të cilat përdoren për:

- mbrojtjen e bimëve apo prodhimeve bimore nga organizmat e dëmshëm ose që e parandalojnë aktivitetin e organizmave të tillë;
- nevoja të konservimit të produkteve bimore;
- shkatërrimin e bimëve të padëshiruara, pjesëve të bimëve, dhe kontrollimin apo shmangien e rritjes së bimëve të padëshiruara.

“Mbetjet e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve” nënkupton një apo më tepër substanca aktive të pranishme në bimë apo në produktet me origjinë bimore, në produktet ushqimore të kafshëve, në tokë, apo kudo tjetër në mjedis, që vijnë si rezultat i përdorimit të PMB, duke përfshirë edhe metabolizmin e tyre ose produktet që janë rezultat i degradimit apo i reaksionit të tyre;

“Preparatet” nënkupton përzierjet ose tretësirat e përbëra nga një apo më tepër substanca aktive;

“Substancat” nënkupton elementet kimike dhe lëndët përbërëse të tyre, të lira në natyrë apo të përfituara artificialisht, duke përfshirë edhe ndotjet si rezultat i procesit të fabrikimit;

“Substancat aktive” nënkupton substancat ose mikro-organizmat që përfshijnë viruset, që në përgjithësi apo në mënyrë specifike, aktiviteti i tyre rezulton në luftimin e organizmave të dëmshëm, bimëve të padëshiruara, dhe pjesëve të bimëve;

“Lista e substancave aktive” nënkupton listën në të cilën përfshihen substancat aktive të autorizuara për përdorim ose të PMB që përdoren edhe në vendet anëtare të BE-së si dhe kushtet që zbatohen për përdorimin e substancave të tilla;

“Bimët” nënkupton bimët e gjalla dhe pjesët e gjalla të bimëve, duke përfshirë pemët e freskëta dhe farërat;

“Prodhimet bimore” nënkupton produktet në gjendje të papërpunuar, apo ato produkte që kanë kaluar vetëm nëpër përgatitjet e thjeshta siç është bluarja, tharja, ose shtypja;

“Organizmat e dëmshëm” nënkupton organizmat dëmtues të bimëve apo produkteve bimore me prejardhje shtazore apo bimore duke përfshirë viruset, bakteret, fitoplazmat dhe patogjenë të tjerë;

“Kafshët” nënkupton kafshët që u takojnë llojeve, të cilat zakonisht mbahen nën përkujdesjen e njeriut;

“Mjedis” nënkupton ujën, ajrin, tokën, llojet e egra të florës dhe faunës dhe raportin reciprok në mes tyre;

“Vendosja në treg” nënkupton furnizimin e tregut me produkte për mbrojtjen e bimëve;

“Autorizimi i PMB” nënkupton procesin e caktuar me të cilin autoriteti kompetent i Ministrisë autorizon, të shoqëruar me certifikatë të regjistrimit që i dorëzohet prodhuesit, për vendosjen në treg, qarkullimin apo përdorimin e PMB brenda territorit të Kosovës;

“Praktikat e mira bujqësore” nënkupton zbatimin e aktiviteteve bujqësore apo menaxhimin e mirë të tokës bujqësore dhe materialit reprodutiv, duke e marrë në konsideratë metodat e shfrytëzimit të pasurisë natyrore dhe zonave bujqësore. Këto praktika përfshijnë kombinimin optimal të masave agroteknike në atë mënyrë që të mbrohet pjelloria e tokës bujqësore, shmangia e ndotjes së mjedisit nga përdorimi i plehrave artificiale-minerale, organikë dhe PMB, si dhe prodhimi i produkteve bimore, me qëllim që të përdoren si artikuj ushqimor, duke përmbajtur sasi më të ulët të mundshme të mbetjeve të PMB;

“Kontrolli i integruar” nënkupton kombinimin optimal të masave biologjike, bio-teknologjike dhe kimike, për kultivimin e bimëve, përmes të cilave përdorimi i produkteve kimike për mbrojtjen e bimëve është i kufizuar në minimumin e nevojshëm për të luftuar popullatën e dëmtuesve në nivele, ku dëmtimi ose humbja e prodhimit nga këta organizma nuk është ekonomikisht i pranueshëm;

“Pajisja për aplikimin të PMB” nënkupton mekanizimin, pajisjet për aplikimin e PMB duke përfshirë edhe pjesët e tyre përbërëse.

“Testimet” nënkupton hulumtimet që përfshijnë shpërndarjen e PMB-ve në mjedis, që mund të zbatohet me leje nga Ministria për qëllime kërkimore apo hulumtuese;

“Etiketa” nënkupton përmbajtjen e shkruar ose të shtypur në paketim, që e shoqëron PMB apo preparatin;

“Udhëzim i përdorimit” nënkupton dokumentin në formë të shkruar për mënyrën e përdorimit, i cili e shoqëron PMB me rastin e vendosjes në treg;

“Paketimi” nënkupton fabrikimin final të një PMB, që është i destinuar për përdorim nga shfrytëzuesi;

“Klasifikimi” nënkupton ndarjen e helmeve në bazë të rrezikshmërisë që paraqesin ato;

“ADI” Accetable daily intake nënkupton sasinë e pesticidit që mund të konsumojë një individ gjatë tërë jetës me një siguri praktike pa efekte të dëmshme në shëndet;

“Shenja T+” nënkupton PMB që klasifikohet në grupin i cili është shumë helmues për organizmat e gjalla dhe që shkakton vdekjen.

“Shenja T” nënkupton PMB që klasifikohet në grupin i cili është helmues për organizmat e gjalla dhe që shkakton vdekjen.

“Ministria” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“Autoriteti kompetent” nënkupton njësinë organizative brenda Ministrisë e cila do të merret me çështjet lidhur me produktet për mbrojtjen e bimëve;

“Organ kompetent” nënkupton Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve;

“Komisioni” nënkupton grupin e ekspertëve të cilët në bashkëpunim me autoritetin kompetent autorizojnë vendosjen në treg dhe përdorimin e PMB-ve;

“Ministritë përkatëse” nënkupton Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministritë tjera relevante të ndërlidhura me produktet për mbrojtjen e bimëve;

“Regjistër” nënkupton listën e PMB-ve të lejuara për qarkullim dhe përdorim në Kosovë.

KREU II

VENDOSJA NË TREG DHE PËRDORIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 3

1. Nuk mund të vendosen në treg apo të përdoren në territorin e Kosovës, PMB që nuk janë të autorizuar ose nuk është lëshuar certifikata e regjistrimit në pajtim me këtë ligj.
2. Prodhimi, ruajtja, dhe vendosja në treg e një PMB të pa autorizuar nuk do të ndalohej, nëse është vlerësuar që mund të përdoret në ndonjë vend tjetër anëtar i BE-së, i cili vend ka bërë vlerësimin në lidhje me autorizimin e tij.
3. Nuk është i nevojshëm autorizimi i PMB nga autoritetet kompetente për te kryer ndonjë test për qëllime hulumtuese apo kërkimore, që nuk përfshinë lejimin e tij të pa autorizuar në mjedis.

Neni 4

1. Një PMB mund të vendoset në treg nëse është i autorizuar nga autoriteti kompetent i Ministrisë, dhe nëse është klasifikuar, ambalazhuar, etiketuar, dhe është shoqëruar me një etiketë dhe me udhëzimin e përdorimit në formë të shkruar në gjuhën zyrtare, në pajtim me këtë ligj.
2. PMB si një substancë aktive mund të vendoset në treg, nëse është i autorizuar nga autoriteti kompetent i Ministrisë, kur është klasifikuar, ambalazhuar, etiketuar, dhe është i shoqëruar me etiketë dhe me udhëzimin e përdorimit i shkruar në gjuhën zyrtare, në pajtim me këtë ligj .
3. PMB nuk mund të vendosen në treg nëse afati i përdorimit të tij ka skaduar.
4. Ministria me akt nënligjor rregullon klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin, dhe shoqërimin e PMB me udhëzimet e përdorimit në pajtim me këtë ligj.

Neni 5

Kushtet për vendosjen në treg të PMB

1. Personat, fizik dhe juridik për veç kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta për objektet, lokalet, pajisjet dhe personelin, duke përcaktuar edhe numrin e regjistrimit për hyrje në regjistrin e subjekteve që mund ti vendosin në treg PMB.
2. Personat fizik dhe juridik sipas paragrafit 1 të këtij neni janë të obliguar të kenë një person përgjegjës për punë me PMB dhe vendosjen në treg të tyre, i cili është përgjegjës për njoftimin, dhënien e këshillave, mbajtjen e shënimeve dhe shitjen e PMB.
3. Personat fizik dhe juridik përgjegjës nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të kenë përgatitje profesionale superiore në lëmin e bujqësisë dhe trajnime profesionale.
4. Regjistri i përcaktuar për personat fizik dhe juridik nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni mbahet nga autoriteti kompetent në të cilin përfshihen të dhënat: emri dhe mbiemri i personit përgjegjës adresa, nënshkrimi si dhe emri dhe mbiemri i personit juridik.
5. Ministria me akt nënligjor e rregullon çështjen e përcaktimit të kushteve që duhet plotësuar sa i përket objekteve dhe pajisjeve për vendosjen në treg të PMB në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

Mbajtja e shënimeve dhe komunikimi i të dhënave

1. Personat fizik dhe juridik të përfshirë për vendosjen në treg të PMB, duhet të mbajnë shënime për sasinë e furnizimit, të vendosura në treg, të deponuara, dhe PMB të shitura. Këto të dhëna i dërgohen organit kompetent të Ministrisë më së largu deri më 10 mars të vitit vijues.
2. Personat fizik dhe juridik sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet që të mbajnë shënime edhe për përdorimin dhe ato dërgohen autoritetit kompetent sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Personat fizik dhe juridik të përfshirë për vendosje në treg të PMB të autorizuara dhe të klasifikuara si të rrezikshme, të shënuar me shenjën T dhe T+, janë të obliguar të mbajnë shënime sipas nën-paragrafit 1 të këtij neni si dhe shënime lidhur me:
 - 3.1. emri i produktit qëllimi dhe afati i përdorimit;
 - 3.2. data e shitjes;
 - 3.3. sasia e shitur;
 - 3.4. emri i personit juridik, numri personal, numri i regjistrimit dhe adresa;
 - 3.5. emri i personit fizik, numri personal dhe adresa;
 - 3.6. nënshkrimi i dorëzuesit dhe pranuesit.
4. Personat, fizik dhe juridik të përfshira për vendosjen në treg të PMB, sipas paragrafit 3 të këtij neni, i ruajnë shënimet deri në pesë vite, me mundësi të rishikimit në bazë të kërkesave të autoritetit kompetent.
5. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, me akt nënligjor e rregullon çështjen e përcaktimit të mbajtjes së të dhënave në pajtim me këtë ligj.

Neni 7

Shitja e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

1. PMB duhet të vendosen në treg sipas klasifikimit, ambalazhimit, dhe qëllimit të përdorimit:
 - 1.1. vetëm në shitore të specializuar për shitjen e tyre;
 - 1.2. në shitore lulesh që nuk ka mallra ushqimorë.

2. PMB të autorizuar, nga paragrafi 1 pika 1.1 e këtij neni, mund të shesin vetëm përdoruesi i cili ka certifikatë të vlefshme që plotëson kushtet sa i përket përgjegjësiwe profesionale sipas nenit 9 paragrafi 1 të këtij ligji.

3. Ministria me akt nënligjor e rregullon çështjen e përcaktimit të pikave të shitjes, në pajtim me këtë Ligj.

Neni 8

Qëllimi i përdorimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

1. PMB duhet përdorur në mënyrë të duhur dhe konform me udhëzimet për përdorim dhe shënime në etiketë, duke përfshirë përgatitjen e koncentrimit, siç është përshkruar në udhëzimin e përdorimit të tyre. Ato duhet të përdorën duke respektuar parimet e praktikave të mira bujqësore, të mbrojtjes bimore të integruar, mbrojtjen e mjedisit dhe organizmave që nuk janë synuar.

2. Përdoruesit e PMB, të cilët kanë për synim mbrojtjen e shëndetit të bimëve, duhet të mbajnë shënime për përdorimin e tyre.

3. Këshilla, rekomandime dhe reklamime, bëhen vetëm për PMB e autorizuar, sipas qëllimeve të specifikuar në autorizim dhe udhëzimet e përdorimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Ministria me akt nënligjor e rregullon, mënyrën e përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, metodën e mbajtjes së shënimeve, deponimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tyre, në pajtim me këtë ligj.

Neni 9

Përdoruesit e produkteve për mbrojtjen e bimëve

1. Personat fizik dhe juridik të përfshirë në aktivitete bujqësore dhe prodhuesit e bimëve, mund të përdorin PMB vetëm nëse kanë përgatitje profesionale dhe që janë të pajisur me mjete përkatëse për përdorim.

2. Ministria me akt nënligjor e rregullon aftësimin e nevojshëm profesional, metodat e përcjelljes së përdorimit dhe vlerësimin e mjeteve për përdorim në pajtueshmëri me këtë ligj.

Neni 10

Mbetjet e PMB në bimë dhe produkte bimore

1. Të gjithë përdoruesit e PMB nuk duhet tejkalar nivelin maksimal të mbetjeve të caktuara të substancave në bimë ose produkte me origjinë bimore.

2. Nëse nivelet e caktuara të mbetjeve në bimë dhe produkte me origjinë bimore, janë tejkalar me përdorimin e PMB, atëherë këto bime apo produkte me origjinë bimore do të asgjësohen.

3. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, me akt nënligjor e rregullon çështjen e caktimit të niveleve maksimale të mbetjeve në bimë dhe produkte me origjinë bimore dhe ndalon përdorimin e tyre që tejkalojnë nivelin maksimal të mbetjeve në pajtim me këtë ligj.

Neni 11

PMB të klasifikuara me shenjën T+

1. PMB të autorizuar që janë klasifikuar në grupin e helmeve të rrezikshme me shenjën T+, nuk lejohet që të vendosen në qarkullim apo në përdorim të përgjithshëm, pa autorizim përkatës të lëshuar nga Ministria.

2. Vendosja në treg dhe përdorimi i PMB sipas paragrafit 1 të këtij neni i lejohet personave fizik dhe juridik me përgatitje profesionale përkatëse dhe të trajnuar për punë me helme të kësaj kategorie.

3. Ministria, me akt nënligjor e rregullon çështjet lidhur me objektet, pajisjet dhe personelin sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 12

Ndalimi i vendosjes në treg dhe kufizimet për përdorim të PMB

1. Nga aspekti i njohurive shkencore dhe teknike, ekzistojnë arsye për të dyshuar që një PMB i autorizuar paraqet rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, atëherë ministria me vendim kufizon apo ndalon vendosjen e tij në treg.

2. Për PMB që vendosja në treg apo përdorimi i tyre është i ndaluar me Direktivat e Komisionit Evropian, atëherë Ministria me vendim e ndalon vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve të tilla.

3. Nuk lejohet përdorimi i PMB:

3.1. nga ajri me anë të aviacionit;

3.2. që shkaktojnë ndotje të objekteve bujqësore;

3.3. objekteve të banimit që shfrytëzohen nga njerëzit dhe për kafshët;

3.4. që shkaktojnë ndotjen e tokës;

3.5. që shkaktojnë ndotjen e ujërave në vendet afër ngastrave që trajtohen.

KREU III

PROCEDURAT E AUTORIZIMIT

Neni 13 Autorizimi

1. Autorizimi i PMB, bëhet nga autoriteti kompetent, në bazë të kërkesës së personave fizik dhe juridik të autorizuar të aplikuesit. Kërkesës për autorizim të PMB i bashkëngjiten dokumentet për vlerësimin e substancave aktive.

2. Substancat aktive dhe PMB duhet të vlerësohen nga ekspertë profesional, dhe varësisht nga fusha e aktivitetit, ekspertet profesional përcaktohen me vendim nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

3. Për vlerësimin e kushteve të autorizimit, bazuar në substancat aktive, të klasifikuara në listë, ose bazuar në vendimet e Komisionit Evropian për të gjitha dokumentet, vlejën të njëjta parime, që rekomandohen nga Ministria, në pajtim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

4. Vlerësimi i kushteve për autorizimin e PMB, bazuar në substancat aktive, që nuk janë klasifikuar në listë dhe nuk janë siguruar dokumentet e nevojshme, sipas nenit 15 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 si dhe kushteve të përcaktuara në nenin 23 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 14 Aplikimi për autorizim

Aplikimi për autorizim të PMB, bëhet nga prodhuesi, personat fizik apo juridik, që veprojnë në emër dhe me autorizim të prodhuesit.

Neni 15 Dokumentacioni për vlerësim të substancave aktive

1. Kërkesës për vlerësim të substancave aktive duhet bashkëngjitur dokumentacionin si në vijim:

1.1. identiteti i substancave aktive;

1.2. vetit fizike dhe kimike;

- 1.3. informacion shtesë për substancat aktive si që janë: përdorimi, mënyra e veprimit, deponimi, masat mbrojtëse dhe të ngjashme;
 - 1.4. metodat analitike;
 - 1.5. studimet toksikologjike dhe metabolike;
 - 1.6. të dhëna për mbetjet e substancave aktive në bimë apo produktet bimore, artikuj ushqimor dhe bimë foragjere;
 - 1.7. të dhëna për rrezikshmërinë dhe mënyrën e veprimit të substancave aktive gjatë përdorimit të tyre në mjedis;
 - 1.8. studimet ekotoksikologjike;
 - 1.9. përmbledhje dhe vlerësim si është përcaktuar në pikën 1.7 dhe 1.8 të këtij paragrafi;
 - 1.10. propozimi dhe shpjegimi i klasifikimit, si dhe shënimet e propozuara në pajtim me Direktivat lidhur me klasifikimin, ambalazhimin, dhe etiketimin e substancave të rrezikshme;
 - 1.11. nëse substanca është organike që përmban mikroorganizma apo viruse, atëherë jepen të dhënat për mikroorganizmat apo viruset;
 - 1.12. dokumentacioni për vlerësimin e preparateve bazuar në substanca të tilla;
 - 1.13. të dhënat për sigurinë gjatë punës;
 - 1.14. të dhëna të tjera, nëse kërkohet.
2. Nëse të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, mungojnë pjesërisht, ato duhet kthyer të bashkangjitura me aplikacion dhe me shpjegim për kompletimin e tyre. Dokumentet e tilla vlerësohen kohe pas kohe.
3. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me akt nënligjor e rregullon përmbajtjen më të detajuar të dokumenteve të nevojshme sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 16 **Dokumentacioni për vlerësimin e PMB**

1. Kërkesës për autorizim të PMB duhet bashkangjitur dokumentacioni si në vijim:
 - 1.1. identiteti i substancave aktive;
 - 1.2. vetitë fizike dhe kimike;
 - 1.3. të dhëna për përdorimin e preparatit;
 - 1.4. metodat analitike;
 - 1.5. të dhënat për efektshmërinë;
 - 1.6. studimet toksikologjike;
 - 1.7. përmbledhje dhe vlerësimi i pikave 1.8 dhe 1.9 të këtij paragrafi;
 - 1.8. propozimi dhe shpjegimi i klasifikimit, si dhe shënimet e propozuara në pajtim me Direktivat lidhur me klasifikimin, ambalazhimin, dhe etiketimin e substancave të rrezikshme;
 - 1.9. të dhënat për sigurinë gjatë punës;

1.10. etiketimi që përfshinë edhe udhëzimet e përdorimit;

1.11. të dhëna të tjera, nëse kërkohet.

2. Kur një PMB përmban substanca aktive të futura në listë, substancat e tilla duhet vlerësuar përsëri, duke marrë parasysh kushtet e futjes në të. Nëse shkalla e pastërtisë dhe natyra e papastërtive nuk dallojnë dukshëm nga të dhënat e parapara në dokumentimin e dorëzuar për përfshirjen e substancës aktive në listë, kërkesës për autorizim duhet ti bashkëngjitet informacioni që identifikon substancën aktive.

3. Nëse të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, mungojnë pjesërisht, ato duhet kthyer të bashkangjitura me aplikacion dhe me shpjegim për kompletimin e tyre. Dokumentet e tilla vlerësohen kohe pas kohe.

4. Pavarësisht prej dispozitave të nenit 15 të këtij ligji dhe paragrafit 1 të këtij neni, njohja e një autorizimi për PMB që është i autorizuar në një vend anëtar të BE-së, mund të pranohet me kushte të përcaktuara me vendim nga Ministria.

Neni 17

Shmangia e ribërjes së testeve në kurrizorë

1. Me rastin e vlerësimit të dokumentacionit për autorizimin e një PMB, pranohen testimet e bëra në kafshë nga vendet anëtare të BE-së, me kusht që testet e tilla të jenë bërë në pajtim me praktika të mira laboratorike.

2. Nëse autoriteti kompetent vlerëson që aplikuesi ka dorëzuar kërkesë për autorizimin e një PMB, që tanimë është autorizuar nga një aplikues tjetër, atëherë ai duhet ta njoftoi aplikuesin për emrin, dhe adresën e përfituesit paraprak të autorizimit.

Neni 18

Mbrojtja e të dhënave

1. Në rastin e zbatimit të procedurës për autorizimin e një PMB, autoriteti kompetent nuk duhet ti përdorë të dhënat e afuara nga aplikuesit e tjerë, si në vijim:

1.1. të dhënat e dokumentacionit të një substancë aktive, që janë të bashkangjitur në aplikacionin për autorizim apo nxjerrje të lejes, vetëm në rastet kur:

1.1.1. aplikuesi i dytë është pajtuar me aplikuesin e parë apo përfituesin e autorizimit që përdorimi mund të bëhet nga të dhëna e tilla, dhe e argumenton këtë me dëshmi përkatëse;

1.1.2. kanë kaluar së paku dhjetë (10) vite, që substanca është futur në listë;

1.1.3. kanë kaluar së paku dhjetë vite, që kur është bërë autorizimi i një substance aktive në ndonjërin vend anëtar të BE-së;

1.1.4. kanë kaluar së paku pesë vite të autorizimit të parë të substancës aktive, përveç nëse periudha pesë vjeçare kalon para periudhës dhjetë (10) vjeçare, e paraparë në pikën 1.1.2. të këtij nën-paragrafi dhe 1.1.3. të paragrafit 1 të këtij neni. Kjo zbatohet në rastet kur ndryshojnë kushtet për futjen e një substance aktive në listë ose për zgjatjen e periudhës së autorizimit të substancës aktive.

2. Mund të përdorën të dhënat e dokumentacionit të një PMB që janë bashkangjitur me rastin e aplikimit për autorizim, vetëm në rastet kur:

2.1. aplikuesi i dytë është pajtuar me aplikuesin e parë apo përfituesin e autorizimit që përdorimi mund të bëhet nga të dhëna e tilla, dhe e argumenton këtë me dëshmi përkatëse;

2.2. kanë kaluar dhjetë vite, që kur është bërë autorizimi i një PMB në ndonjërin vend anëtar të BE-së që përmban substanca aktive.

Neni 19
Mbajtja e të dhënave në fshehtësi

1. Autoriteti kompetent, pa cenuar dispozitën e nenit 15 paragrafi 1 pika 1.7 të këtij ligji që lejojnë qasjen e lirë në informatat dhe të sigurojnë se informacionet në dokumentet e dorëzuara nga aplikuesi për autorizim të PMB, duke përfshirë këtu të dhëna për aktivitetin industrial dhe komercial të të njëjtit, do të trajtohet në mënyrë të fshehtë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga aplikuesi.

2. Mbajtja në të fshehtë nuk zbatohet për:

- 2.1. emrin dhe përmbajtjen e substancave aktive dhe emrin e PMB;
- 2.2. emrin e substancave tjera që janë klasifikuar si të rrezikshme, siç janë të përcaktuara në Direktivat 67/548/EEC dhe 78/631/EEC;
- 2.3. të dhënat fiziko-kimike lidhur me substancat aktive dhe PMB;
- 2.4. mënyrën e paraqitjes së të dhënave të substancave aktive ose PMB të dëmshme;
- 2.5. përmbledhje e rezultateve të testeve për të caktuar efektshmërinë e substancës ose PMB, dhe parrezikshmërinë e tyre ndaj njerëzve, kafshëve, dhe mjedisit;
- 2.6. metodat dhe masat paraprake për të evituar kontaktet fizike, mënyrën e deponimit, ruajtjes, transportimin, rrezikun e paraqitjes së zjarrit dhe rreziqet e tjera;
- 2.7. metodat për përcaktimin e përmbajtjes së substancave aktive, ndotjet dhe përbërës të tjerë të substancave aktive dhe mbetjet e PMB;
- 2.8. metodat e vendosjes në treg dhe ambalazhimit të PMB;
- 2.9. procedurat e dekontaminimit të cilat duhet ndjekur në rast të derdhjes apo rrjedhjes aksidentale;
- 2.10. ndihma e parë dhe trajtimi mjekësor që duhet ti jepet personit në rast lëndimi.

3. Nëse aplikuesi më pas bën hapjen e informacionit që më parë ishte e fshehtë atëherë kërkohet nga ai që ta njoftojë autoritetin kompetent në lidhje me këtë.

KREU IV

AUTORIZIMET

Neni 20
Autorizimi i PMB

1. Autorizimi për një PMB, i referuar në nenet 23, 24, 25, 26, dhe 27 të këtij ligji, duhet të lëshohet nga Ministria në bazë të propozimit nga autoriteti kompetent, duke marrë parasysh vlerësimet e bëra të dokumentacionit, siç është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas pranimit të aplikacionit.

2. Nëse autoriteti kompetent nuk jep autorizimin apo anulon, atëherë në formë të shkruar jepet arsyetim.

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, propozimi i autoritetit kompetent, nuk duhet të jetë i domosdoshëm për korrigjimet në autorizim të PMB, por bazohet në ndryshimet:

- 3.1. të cilat nuk kanë efekte të mëdha negative në shëndetin e njeriut dhe të kafshëve;
- 3.2. emrit komercial;

- 3.3. emrit të prodhuesit apo përfaqësuesit;
- 3.4. ndryshimi i përbërjes, që nënkupton ndryshime të vogla sipas standardeve ndërkombëtare.
4. Autorizimi i PMB bëhet në emër të prodhuesit apo përfaqësuesit të autorizuar nga prodhuesi.
5. Vendimi për autorizim duhet të përmbajë të dhënat si vijon:
 - 5.1. emrin me të cilin do të tregtohet PMB;
 - 5.2. emrin dhe përmbajtjen e substancave aktive dhe substancave tjera të rrezikshme në PMB;
 - 5.3. informata për përdorimin, klasifikimin dhe udhëzimet e përdorimit të PMB-së;
 - 5.4. vendi i shitjes;
 - 5.5. për periudhën e pritjes prej momentit të përdorimit të PMB deri në momentin e konsumimit të produkteve të trajtuara dhe
 - 5.6. nivelet e mbetjeve maksimale të PMB.

Neni 21 **Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e PMB**

1. Komisioni duhet të përbehet nga ekspertë në lëmin përkatëse, të caktuar nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Anëtarët e komisionit nuk duhet të jenë në ndonjë lidhje të ngushtë, nga aspekti i interesave të papranueshme, me aplikuesin, personat fizik dhe juridik, të cilët prodhojnë apo vendosin në treg PMB.
3. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me vendim e rregullon përbërjen e Komisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 22 **Kushtet e Autorizimit**

1. PMB, mund të autorizohen, nëse një substancë ose substancat aktive të tyre, janë të radhitura në listën e substancave të lejuara për përdorim sipas Shtojcës I të Direktivës 91/414/EEC dhe në bazë të të dhënave që përfshihen në dosje sipas nenit 16 paragrafit 1 të këtij Ligji dhe nëse është në pajtim me kushtet e parapara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, PMB mund të autorizohen duke u bazuar në dosjen e dokumenteve të parapara në nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 paragrafi 1 të këtij Ligji.
3. Substanca aktive ose substancat aktive të PMB sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni që janë në procedurë për futjen në listë, duhet të merren parasysh edhe kërkesa si vijon:
 - 3.1. nëse vepron në mënyrë efektive;
 - 3.2. nuk ka ndonjë efekt të paparashikueshëm me rastin e kultivimit të bimëve apo në produkte bimore;
 - 3.3. nuk shkakton dhimbje të panevojshme dhe vuajtje për kurrizorët dhe kafshët tjera të synuara;
 - 3.4. nuk ka ndonjë efekt të dëmshëm të drejtpërdrejtë apo anësor në shëndetin e njeriut dhe të kafshëve;
 - 3.5. nuk ka ndonjë efekt negativ në mjedis, në veçanti në ndotjen e ujit, duke përfshirë ujin e pijshëm dhe ujërat nëntokësore, si dhe organizmat që nuk janë synuar.

4. Sasia e substancave aktive, ndotësve toksikologjik dhe ekotoksikologjik mund të caktohen me metoda të pranuar dhe të harmonizuara në pajtim me nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 të Direktivës 91/414/EEC.
5. Mbetjet toksike të substancave që rezultojnë nga përdorim i një PMB të autorizuar që kanë efekt në shëndetin e njeriut, kafshëve, dhe në mjedis, mund të caktohen nëpërmes analizave të duhura.
6. Dokumentet sipas nenit 15 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 të këtij ligji që janë bashkangjitur në kërkesën për autorizim, duhet të vlerësohet duke u bazuar në të dhënat e testimave dhe analizave.
7. Testet dhe analizat e bëra në kushte të prodhimit bujqësor, për mbrojtjen e bimëve dhe ndikimit në mjedis, që janë të krahasueshme me kushtet e Kosovës, janë të pranueshme me rastin e autorizimit të një PMB. Testet dhe analizat për caktimin e efikasitetit të PMB, duhet të bëhen nga institutet referente të cilat plotësojnë kushtet për zbatimin e praktikave të mira laboratorike.
8. PMB e parapara për përdorim në bujqësi, mund të autorizohen edhe për përdorim në sipërfaqe jobujqësore, nëse plotësohen kushtet e cekura në paragrafin 3 pikat 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të këtij neni.
9. Ministria me akt nënligjor e rregullon testimet e PMB, analizat e tyre dhe zbatimin e praktikave të mira laboratorike.

Neni 23

Vlefshmëria dhe kohëzgjatja e autorizimit për PMB

1. Ministria në bazë të propozimit të Komisionit mund të jap autorizim për një PMB në afat kohor më së shumti deri dhjetë (10) vite për përdorim të tij.
2. Autorizimi mund të zgjatet një apo më shumë herë dhe secilën herë afati kohor për vendosjen e tij në treg është deri dhjetë (10) vite. Kërkesa për zgjatjen e autorizimit, duhet paraqitur nga përfituesi paraprak i autorizimit, autoriteteve kompetente të Ministrisë së paku dymbëdhjetë (12) muaj para afatit të skadimit të autorizimit paraprak.
3. Në rastet e ndryshimit të të dhënave paraprake për një PMB të autorizuar më parë ose që priten të ndryshohen, atëherë përfituesi i autorizimit kërkon nga Autoriteti kompetent që i tërë dokumentacioni për vlerësimin e PMB apo pjesa e dokumentacionit paraprak me të cilin është autorizuar, duhet të vlerësohet për vazhdimin e autorizimit.
4. Një PMB i autorizuar, mund të rivlerësohet në çfarëdo kohe nëse mendohet që kërkesat e parashtruara në nenin 22 paragrafi 3 pika 3.1 deri 3.4 të këtij ligji, nuk janë plotësuar. Në rast të rivlerësimit të dhëna shtesë dhe dokumentacioni i PMB, i ofrohet autoritetit kompetent nga përfituesi i autorizimit, personat juridik apo fizik të autorizuar, të cilit i është dhënë e drejta e vendosjes në treg dhe përdorimi i vazhduar i PMB.

Neni 24

Autorizimi i përkohshëm

1. Nëse një PMB përmban substancë aktive të re, për të cilën aplikuesi paraqet kërkesën për autorizim me dokumentet e parashtruara në nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 paragrafi 1 të këtij ligji, Ministria lëshon autorizim të përkohshëm, deri tri vite për përdorim të tij, nëse vërtetohet që i njëjti produkt është lejuar për përdorim nga vendet anëtare të BE-së dhe që i plotëson kushtet e parashtruara në nenin 22 paragrafi 3 pikat 3.1 deri 3.4 të këtij ligji.
2. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për autorizim të përkohshëm, siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni, në kërkesë duhet të specifikohet niveli maksimal i mbetjeve.
3. Bazuar në vendimet e Komisionit Evropian, për zgjatjen e kufizimit kohor të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, Ministria mund ta zgjatë autorizimin e përkohshëm të PMB.

Neni 25

Ndryshimet e autorizimeve

1. Në bazë të kërkesës së përfituesit të autorizimit, ose kërkesës së autoritetit kompetent të Ministrisë, autorizimi mund të ndryshohet.
2. Në bazë të propozimit të përfituesit të autorizimit, autorizimi mund të ndryshohet, nëse PMB është i të njëjtit prodhues me një emër tregtues tjetër në ndonjërin vend anëtar të BE-së dhe nëse ai është identik me PMB e autorizuar në Kosovë.
3. Autoriteti kompetent i Ministrisë, mund të kërkojë të dhëna tjera plotësuese dhe mostra, në rastet e vlerësimit për ndryshimet e autorizimit.

Neni 26 Skadimi i autorizimit

1. Autorizimi për vendosjen në treg dhe përdorim të PMB skadon në rastet:
 - 1.1. e përfundimit të periudhës për të cilën autorizimi është lëshuar dhe nëse ky autorizim nuk është përsëritur me kërkesën tjetër;
 - 1.2. pezullimit të autorizimit;
 - 1.3. kur përfituesi i autorizimit e kërkon një gjë të tillë;
 - 1.4. kur kushtet për autorizim nuk plotësohen;
 - 1.5. e ndalimit të vendosjes në treg apo përdorimit të një PMB brenda territorit të Kosovës sipas nenit 12 të këtij ligji;
 - 1.6. kur përfituesi i autorizimit nuk dorëzon dokumentacionin e parashtruar në nenin 16 paragrafi 1 të këtij ligji, brenda afatit kohor të përcaktuar;
 - 1.7. kur substanca aktive është hequr nga lista;
 - 1.8. e anulimit të autorizimit të përkohshëm, nëse substanca aktive e cila është subjekt i rasteve të parapara me nenin 24 të këtij ligji dhe që nuk është e përfshirë në listë.
2. Në rastet kur përfituesi i autorizimit, kërkon që PMB nuk do ta vendos në treg gjashtë muaj para skadimit të afatit të autorizimit apo që do të përdoret më tutje, ai duhet ta informojë autoritetin kompetent, dhe ti bashkëngjitet një shpjegim.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 pikat 1.1 deri 1.8 të këtij neni një PMB mund të plasohet në treg për së paku tetëmbëdhjetë (18) muaj në vijim pas skadimit të afatit, i mbuluar me autorizim, në mënyrë që të shitet materiali ekzistues.
4. Përjashtimisht nga paragrafi 1 pikat 1.1 deri 1.4 të këtij neni, Ministria mund të vendos, që pas skadimit të afatit, të mbuluar me autorizim, materiali i PMB të tilla duhet hequr në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-30 për mbeturina.
5. Në vendimin e pezullimit të autorizimit të PMB, Ministria mund ti japë përfituesit të autorizimit një periudhë shtesë për të shitur materialin ekzistues të PMB, apo të vendosë për heqjen nga tregu në pajtim me Ligjin Nr.02/L-30 për mbeturina.

Neni 27 Njohja reciproke e autorizimeve

1. Aplikuesi mund të kërkojë autorizimin për një PMB, i cili përmban një substancë aktive apo substanca aktive të përfshirë në listë, bazuar në autorizimin e lëshuar nga një vend anëtar i BE-së, po qe se autorizimi i tillë është bërë në pajtim me parimet e njëjta për vlerësimin e PMB, sipas nenit 22 paragrafi 7 të këtij ligji.

2. Aplikacionit duhet bashkangjitur dokumentacionin me shkresë që arsyeton krahasimin e kushteve dhe materialin e parashtruar në nenin 16 paragrafi 1 pika 1.4 të këtij Ligji.

3. Nëse autoriteti kompetent hedhë poshtë kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, për shkak të pamundësisë së krahasimit sipas nenit 22 paragrafi 7 të këtij Ligji dhe gjithashtu për kushtet shtesë në lidhje me përdorimin e PMB, siç është ndjeshmëria specifike në mjedis në disa zona të caktuara dhe mënyra e konsumimit të ushqimit, atëherë arsyetimi ipet në formë të shkruar .

4. Përdorimi i propozuar i PMB sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të ndryshojë gjatë procedurës së autorizimit, në mënyrë që të eliminohet joharmonizimi me nenin 22 paragrafi 7 të këtij ligji.

5. Vendimi për autorizimin e PMB bazohet në kushtet, dhe masat e parapara me Direktivën 91/414/EEC.

6. Ministria mund të kufizojë përdorimin e PMB duke u bazuar në mënyrat e konsumimit të ushqimit dhe parandalon ekspozimin e konsumatorëve nga ushqimet e ndotura të cilët tejkalojnë konsumimin e lejuar ditor - ADI të mbetjeve të PMB.

Neni 28

Informimi për efektet me rrezik potencial që shkaktojnë PMB

1. Përfitues i autorizimit të PMB apo atyre të cilëve u është dhënë e drejta e zgjerimit të fushës së aplikimit të një PMB të autorizuar, menjëherë e njoftojnë autoritetin kompetent për të gjitha informatat e reja për efektet me potencial të lartë të rrezikut, që mund të shkaktojnë PMB, apo mbetjet e tyre që kanë ndikim në shëndetin e njeriut, kafshëve, ujërave nëntokësorë dhe mjedis.

2. Obligimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen edhe për përdoruesit e PMB.

KREU V

REGJISTRI I PMB

Neni 29

Mbajtja dhe publikimi i regjistrit

1. Bazuar në autorizimet e lëshuara, autoriteti kompetent mbanë regjistër të PMB.

2. Ministria për çdo vit bënë publike në Gazetën Zyrtare të Kosovës Listën e PMB të autorizuar.

3. Në periudhat e ndryshme kohore, Ministria publikon ndryshimet dhe plotësimet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 30

Përmbajtja e regjistrit të PMB të autorizuar

1. Regjistri i PMB përmban këto të dhëna:

1.1. emrin tregtar të PMB-së;

1.2. emrat dhe përmbajtësit e të gjitha substancave aktive;

1.3. emri i prodhuesit dhe përfaqësuesit në Kosovë;

1.4. klasifikimi sipas grupit të rreziqeve;

1.5. numri dhe data e autorizimit, dhe afati i skadimit;

1.6. pikat e shitjes të specifikuar në nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji.

Neni 31

Lista e substancave aktive

1. Substancat aktive që i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas nenit 15 paragrafi 1 dhe nenit 22 paragrafin 1, 3 pika 3.1 deri 3.5 dhe paragrafin 7 të këtij ligji, duhet futur në listë duke marrë parasysh edhe procedurat e përcaktuara nga Komisioni Evropian.
2. PMB me substanca aktive që i plotësojnë kushtet sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe bazuar në të arriturat shkencore teknike, atëherë ajo futet në Listë në afat kohor deri dhjetë (10) vite.
3. Përfshirja e një substance aktive në listë, ndryshimet e listës, apo heqja nga lista, bëhet nga Ministria, duke u bazuar edhe nga të dhënat e paraqitura nga vendet anëtare të Komisioni Evropian.
4. Ministria publikon në Gazetën Zyrtare të Kosovës Listën e substancave aktive për çdo vit.
5. Përjashtim nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, përfshirja e një substance aktive në listë, bëhet nëse i plotëson kushtet:
 - 5.1. përcaktimi i sasisë së lejuar të konsumit ditor - ADI për njerëzit;
 - 5.2. përcaktimi i ekspozimit të pranueshëm për përdoruesit;
 - 5.3. përcaktimi i veprimit të rrezikshëm, shpërndarjes në mjedis, dhe ndikimi në llojet që nuk janë synuar.
6. Me rastin e përfshirjes në listë për herë të parë substancës aktive, duhet caktuar:
 - 6.1. shkallën minimale të pastërtisë së substancës aktive;
 - 6.2. natyrën dhe përmbajtjen maksimale të ndotësve;
 - 6.3. kufizimet që dalin nga vlerësimi i parametrave të kërkuar sipas nenit 22 paragrafi 3 të këtij ligji;
 - 6.4. llojin e preparatit dhe
 - 6.5. mënyrën e përdorimit.
7. Në bazë të kërkesës se aplikuesit, përfshirja e një substance aktive në listë mund të bëhet një apo disa herë, në kohëzgjatje deri dhjetë (10) vite.
8. Aplikacioni për të vazhduar autorizimin duhet paraqitur së paku dy vite para skadimit të afatit. Nëse periudha kohore e cekur skadon gjatë verifikimit, Ministria mund ta zgjasë kohën për përfshirjen në listë të substancës aktive deri në marrjen e një vendimi.

Neni 32 Lejet për hulumtim

1. PMB të përfshira për qëllime kërkimore ose hulumtuese në zona të caktuara testuese, lejohen të përdorën me vendim të përcaktuar nga Ministria.
2. Në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, leja lëshohet nga Ministria sipas procedurës administrative, duke u bazuar në vlerësimin dhe propozimin e autoritetit kompetent.
3. Të dhënat e PMB, sasia, zona e testimit dhe kushtet për shfrytëzim, si dhe personat fizik dhe juridik të cilët do të kryejnë testimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jenë të regjistruar në një regjistër të veçantë.
4. Leja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet për dy (2) vite. Ajo mund të zgjatet edhe për dy (2) vite të tjera me kusht që aplikuesi të parashtrijë kërkesë katër (4) muaj para skadimit, duke dhënë arsyetim në formë të shkruar.

5. Nëse autoriteti kompetent vendos që eksperimentet e propozuara, të cilat i nënshtrohen kërkesës së dorëzuar për lëshimin e lejes, janë të rrezikshme dhe kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe të kafshëve apo kanë ndonjë ndikim të mundshëm negativ në mjedis. Ministria mund të ndaloj testimet dhe hulumtimet e tilla.

6. Ministria me vendim të veçantë rregullon kushtet për lëshimin e lejes për testim dhe hulumtim.

Neni 33 Lejet e veçanta

1. Në rastet e paraqitjes së ndonjë rreziku të pa parashikuar që shfaqin organizmat e dëmshëm, dhe të cilat nuk mund të luftohen apo nuk mund të kufizohet dëmi i tyre me përdorimin e PMB të autorizuar, Ministria me propozimin e autoritet kompetent mund të lëshoj leje të veçantë për vendosjen në treg apo shfrytëzimin e PMB-ve, të pa autorizuar.

2. Procedura për lëshimin e lejes së veçantë dhe për shfrytëzimin e PMB të pa autorizuar, iniciohet me propozim të përdoruesit.

3. Leja e veçantë lëshohet në afatin kohor njëqindnjëzet (120) ditësh.

4. Leja e veçantë përmban të dhënat si në vijim:

4.1. sasinë e PMB që do të përdorët;

4.2. zonën apo vendin;

4.3. kushtet për shfrytëzim;

4.4. kulturën bimore në të cilat përdoret PMB i pa autorizuar dhe

4.5. të dhënat e shfrytëzuesit.

5. Leja e veçantë mund të ndryshohet apo të tërhiqet nga organi kompetent, nëse:

5.1. nuk ka dhënë rezultate të kërkuara;

5.2. nuk është i nevojshëm përdorimi i tij dhe

5.3. pasojat që mund të sjellin PMB janë më të mëdha se sa dëmet e shkaktuara nga organizmat e dëmshëm.

Neni 34 Leja e veçantë për përdorim të PMB në sasi të vogla

1. Personat juridik që merren me veprimtari bujqësore apo personat fizik, të angazhuar në mënyrë profesionale në prodhimtarinë bujqësore, mund të kërkojnë nga organi kompetent, lejen për shfrytëzim në sasi të vogla të PMB të autorizuar.

2. Organi kompetent lejon shfrytëzim në sasi të vogla të PMB të autorizuar, duke u bazuar në kërkesën e parashtruar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 35 Leja për vendosjen në treg të PMB që janë të autorizuar në vendet anëtare të BE

1. PMB, të cilat janë të autorizuar në ndonjërin prej vendeve anëtare të BE-së, mund të vendoset në tregun e Kosovës, nëse lëshohet leja nga Ministria.

2. Leja për vendosjen në treg të PMB sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet për periudhë të caktuar nga Ministria, duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1-4 të këtij ligji.

3. Aplikuesi i kërkesës për leje sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe që ka emër të njëjtë, i bashkëngjitet informatat si në vijim:

- 3.1. emri dhe adresa e aplikuesit;
- 3.2. emri dhe numri i autorizimit të PMB në ndonjërin vend anëtar të BE-së;
- 3.3. emri dhe adresa e përfituesit të autorizimit PMB dhe emri i vendit anëtar të BE-së që ka lëshuar autorizimin;
- 3.4. substanca aktive, formulimi, paketimi, etiketimi;
- 3.5. emri i propozuar për vendosje në treg të Kosovës;
- 3.6. etiketa e propozuar në gjuhën e përdoruesit në pajtim me Direktivën 67/548/EEC.

4. Pa si të jepet leja sipas paragrafit 2 të këtij neni, në etiket duhet të shënohet emri dhe adresën e prodhuesit dhe përfaqësuesit të autorizuar për vendosje në tregun e Kosovës të PMB.

5. Autoriteti kompetent mund të kërkojë nga pala që të dorëzojë mostrën e PMB, e cila i bashkëngjitet dokumentacionit dhe kërkesës për leje për vendosje në treg si në paragrafin 1 të këtij neni.

6. Pasi të jetë dhënë leja për vendosjen në treg të një PMB të njëjtë, i autorizuar në vendet anëtare të BE-së, personi fizik apo juridik mund të bëjë ripaketimin e tij edhe në vend, por duhet të pajset me autorizim dhe leje të veçantë të lëshuar nga Ministria.

7. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, leja për vendosjen në treg e PMB të njëjtë që është i autorizuar në vendet anëtare të BE, mund të lëshon gjithashtu duke u bazuar në kërkesën e bërë nga personat fizik apo juridik.

8. Organi kompetent lëshon leje për vendosjen në treg të vetëm një PMB të njëjtë që është i autorizuar edhe në vendet anëtare të BE –së, nëse ai është për shfrytëzim vetanak.

9. Kërkesës sipas paragrafit 8 të këtij neni i bashkëngjitet arsyetim, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, dhe dokumentet si në vijim:

- 9.1. diploma apo certifikata profesionale e vlefshme për trajnimet e kryera siç është e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 1 të këtij ligji;
- 9.2. dëshmitë që PMB është e paraparë për përdorim vetanak dhe nuk vendoset në treg nga personi i tretë apo për persona të tretë;
- 9.3. sasia e PMB që përdoren në kulturat bimore;
- 9.4. procedurat dhe mënyrat e përdorimit;
- 9.5. vendi i përdorimit; dhe
- 9.6. informacione shtesë nëse kërkohen nga organi kompetent.

10. Ministria me akt nënligjor rregullon ripaketimin, shfrytëzimin e emrit të propozuar tregtar të PMB që vendosen në tregun e Kosovës, si dhe përmbajtjen e dokumentacionit dhe kërkesës të PMB të njëjtë që është i autorizuar dhe që përdoret në vendet anëtare të BE-së.

KREU VI

SHËRBIMET PROFESIONALE

Neni 36 Obligimet

1. Obligimet për kryerjen e shërbimeve profesionale nga personat juridik dhe fizik të autorizuar nga Ministria, në lëmin e PMB, si dhe pajisjet për aplikim të tyre janë si në vijim:

1.1. kryerja e vazhdueshme e aktivitetit si dhe shërbimeve në pajtim me kërkesat sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore;

1.2. kryerja e shërbimeve sipas programit të specifikuar nga organi kompetent i Ministrisë.

2. Nëse ofruesit e shërbimeve profesionale sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk sigurojnë shërbime të pranueshme sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore, shfrytëzuesi i shërbimeve mund të kërkojë nga organi kompetent i Ministrisë, të vendos për të drejtat e shfrytëzuesit, duke imponuar kryerjen e shërbimit.

3. Ministria me akt nënligjor i rregullon obligimet për kryerjen e shërbimeve profesionale nga personat fizik dhe juridik në lëmin e PMB dhe pajisjeve për aplikimin e tyre.

Neni 37 Shërbimet profesionale

Shërbimet profesionale në lëmin e PMB përfshijnë, autorizimin, tregtimin, aplikimin, shfrytëzimin e PMB dhe shërbime profesionale në lëmin e pajisjeve për aplikim të tyre.

Neni 38 Shërbimet profesionale për autorizimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe pajisjet për aplikim të PMB

1. Shërbimet profesionale në fushën e autorizimit, vendosjes në treg si dhe përdorimit të PMB përfshijnë si në vijim:

1.1. testimet dhe vlerësimi i PMB për procedurën e autorizimit;

1.2. koordinimi i punës dhe mbështetja teknike për autoritetin dhe organin kompetent gjatë procedurës së autorizimit të PMB;

1.3. testimet laboratorike të PMB nga institutet referente;

1.4. monitorimi i mbetjeve të PMB;

1.5. përgatitja e programeve dhe aftësimin i personave për përdorimin e duhur të PMB nga një institucion referent;

1.6. përgatitja e materialeve për vlerësimin e njohurive apo argumenti profesional;

1.7. përgatitja e materialeve dhe programit për zbatimin dhe zhvillimin e procedurave të reja, për praktikatat e mira bujqësore dhe praktikave për mbrojtjen e integruar të bimëve;

1.8. zbatimi i standardeve Evropiane në lëmin e testeve biologjike për efikasitetin e PMB;

1.9. grumbullimi i të dhënave për vendosjen në treg dhe përdorimi i PMB;

1.10. përcaktimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me trajnimet profesionale të personave përgjegjës për vendosjen në treg të PMB dhe për shfrytëzuesit e tyre;

1.11. përgatitja e dokumentacionit për tregtimin dhe përdorimin e pajisjeve;

1.12. përcaktimi i detyrave që kanë të bëjnë me trajnimin profesional në lëmin e pajisjeve për aplikim të PMB;

- 1.13. përcaktimin e aktiviteteve hulumtuese për pajisjet, bashkëpunimi në prezantimin, zhvillimin dhe themelimin e sistemit informues në lëmin e pajisjeve.

Neni 39
Programi i shërbimeve profesionale

Bazuar në programin e shërbimit profesional për personat fizik dhe juridik, Ministria me akt nënligjor rregullon llojin dhe kohëzgjatjen e shërbimit profesional në lëmin e PMB dhe mënyrën dhe dinamikën e kryerjes së shërbimeve profesionale.

Neni 40
Mbikëqyrja e kryerjes së shërbimeve profesionale

1. Mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve profesionale në lëmin PMB dhe aplikimin e tyre, e zbaton organi kompetent i Ministrisë.
2. Mbikëqyrja profesionale mund të zbatohet edhe nga personat juridik dhe fizik, të cilët janë profesionalisht të trajnuar për mbikëqyrjen e fushave të caktuara, që janë të autorizuar nga Ministria.
3. Inspektimi i shërbimeve profesionale në lëmin e PMB do të zbatohet nga inspektorët fitosanitar dhe të bujqësisë.

Neni 41
Kushtet për kryerjen e shërbimeve profesionale

1. Personat fizik dhe juridik, të përmbushin kushtet për përdorim dhe aplikim të PMB si në vijim;
 - 1.1. të kenë pajisje përkatëse për aplikimin e PMB;
 - 1.2. personat të cilët janë të kyçur në aktivitete e tilla, duhet të kenë përgatitje profesionale përkatëse.
2. Ministria me akt nënligjor, rregullon kushtet lidhur me pajisjet, përgatitjen profesionale të personelit të personave fizik dhe juridik dhe kërkesat tjera sipas këtij ligji.

Neni 42
Certifikimi i pajisjeve

1. Personat fizik dhe juridik pronar të pajisjeve, duhet të garantojnë që pajisjet të cilat përdoren për aplikim e PMB nuk janë të dëmshme për njerëzit dhe mjedisin.
2. Lejohen të vendosen në treg dhe të përdoren për aplikimin e PMB, vetëm pajisjet të cilat plotësojnë kushtet për certifikim.
3. Përpara se të plasohet në treg, prodhuesi apo importuesi i pajisjeve, në bazë të kërkesës, duhet të marrin certifikatën nga organi kompetent i Ministrisë, me të cilën lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i pajisjeve të certifikuara.
4. Ministria me akt nënligjor rregullon kushtet e nevojshme për certifikimin e pajisjeve, si dhe do të bëjë publike llojet e caktuara të pajisjeve të certifikuara dhe atyre që nuk lejohen të përdoren për aplikimin e PMB.

Neni 43
Organi kompetent për certifikim

1. Organi kompetent për certifikim i autorizuar nga Ministria duhet ti përmbush kushtet e përcaktuara lidhur me personelin dhe mjetet për vlerësimin e pajisjeve për aplikimin e PMB.
2. Organi kompetent për certifikim të pajisjeve për aplikimin e PMB, caktohet nga Ministria.

3. Prodhuesi apo importuesi i pajisjeve për aplikimin e PMB, i paraqet kërkesën organit kompetent të Ministrisë për certifikimin e pajisjeve.

4. Organi kompetent i Ministrisë dhe organi kompetent i autorizuar për certifikim do të mbajnë shënime si në vijim;

4.1. të dhënat për llojin,

4.2. të dhënat për tipin,

4.3. vitin e prodhimit të pajisjes,

4.4. të dhënat për vitin e certifikimit,

4.5. emrin e prodhuesit dhe të importuesit.

5. Shënimet sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të ruhen së paku dhjetë (10) vite pas lëshimit të certifikatës.

6. Në çdo kohë shënimet sipas paragrafit 4 të këtij neni mund të rishikohen nga organi kompetent i Ministrisë.

7. Ministria me akt nënligjor i rregullon kushtet sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 44 Inspektimi i rregullt i pajisjeve

1. Pronarët dhe përdoruesit e pajisjeve për aplikimin e PMB, duhet të përdorin vetëm pajisjet, të cilat i nënshtrohen rregullisht inspektimeve.

2. Pajisjet për aplikimin e PMB të inspektuara nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të mbajnë shenjën dhe vulën e inspektimit të rregullt.

3. Pronarët dhe përdoruesit e pajisjeve për aplikimin e PMB, do të marrin vulën e inspektimit të rregullt çdo dy (2) vite.

4. Ministria me akt nënligjor rregullon llojet e pajisjeve që nuk janë të nevojshme për inspektim.

Neni 45 Vula e inspektimit të rregullt

1. Vulosjen e pajisjeve për aplikimin e PMB të inspektuara e bënë organi kompetent i Ministrisë.

2. Organi kompetent i Ministrisë, bazuar në të dhënat e organit kompetent për certifikim, vulos vetëm pajisjet për aplikim të PMB, që janë teknikisht të rregullta.

3. Organi kompetent i Ministrisë dhe organi kompetent për certifikim të pajisjeve, mbajnë shënime si në vijim;

3.1. për rezultatet e inspektimeve;

3.2. emrin e pronarit dhe përdoruesit të pajisjeve të inspektuara;

3.3. ditën e vendosjes së vulës në pajisjet e inspektuara.

4. Shënimet e rezultateve të inspektimit të pajisjes së veçantë do të mbahet gjashtë (6) vite.

5. Ministria me akt nënligjor rregullon kushtet e përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, metodat e inspektimeve të rregullta të pajisjeve, mbajtja e shënimeve dhe formën e vulës për inspektimet e rregullta.

Neni 46 Shpenzimet

1. Shpenzimet që kanë të bëjnë me autorizimin e PMB dhe lëshimin e lejeve kompensohen nga aplikuesi apo përfituesi i autorizimit.
2. Shpenzimet që kanë të bëjnë me lëshimin e certifikatës së pajisjeve për aplikimin e PMB kompensohen nga prodhuesi apo importuesi.
3. Shpenzimet e krijuara për inspektimet e rregullta të pajisjeve për aplikim të PMB kompensohen nga pronarët dhe përdoruesit e pajisjeve.
4. Shpenzimet për analizimin e bimëve apo produktet bimore lidhur me përmbajtjen e mbetjeve të PMB, kompensohen nga pronari i bimëve apo produkteve me origjinë bimore, nëse mbetjet e PMB kalojnë vlerat e lejuara.
5. Shpenzimet për analizimin e tokës dhe objekteve të tjera lidhur me mbetjet e PMB apo substancës aktive, kompensohen nga pronari i tokës, nëse vërehet që është bërë përdorimi jo i rregullt apo i ndaluar i PMB.
6. Shpenzimet për analizimin e tokës dhe objekteve tjera, të bërë sipas kërkesës së klientit të bimëve apo produkteve bimore, kompensohen nga shfrytëzuesi i PMB, nëse mbetjet e tyre kalojnë vlerat e lejuara, në të kundërtën, shpenzimet e tilla do të kompensohen nga klienti dhe në rastet kur vet klienti kërkon inspektime të rregullta.
7. Shpenzimet për ekzaminimin e PMB dhe inspektimet kompensohen nga përfituesi i autorizimit të PMB, edhe nëse ato si të tilla nuk i plotëson kushtet për autorizim.
8. Shpenzimet për testimin e pajisjeve për aplikimin e PMB, do të kompensohen nga prodhuesi apo importuesi, edhe nëse pajisja nuk i plotëson kushtet e parashtruara në certifikatë.
9. Ministria me akt nënligjor e rregullon shumën e shpenzimeve të krijuara me rastin e zbatimit të këtij neni.

KREU VII

IMPORTI

Neni 47

Importi i produkteve për mbrojtjen e bimëve

1. PMB, lejohen të importohen vetëm nga personat fizik dhe juridik, siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij ligji. Të dhënat për importin e PMB raportohen në zyrat e organit kompetent, sipas nenit 6 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji.
2. Importi dhe vendosja e PMB do të mbikëqyret nga inspektorët fitosanitar.
3. Ministria me akt nënligjor rregullon pikat e vendkalimit kufitar për importin apo kalimin transit të PMB.

Neni 48

Importimi i pajisjeve për aplikimin e PMB

1. Lejohen të importohen vetëm pajisjet, për të cilat është dhënë certifikata apo Leja e importit nga Organi Kompetent i Ministrisë.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, pjesët e pajisjeve për aplikimin e PMB, Ministria mund të caktoj që për disa lloje të tyre, të lejohet importi pa certifikatë apo leje.

KREU VIII

AUTORIZIMET

Neni 49

Autorizimi dhe detyrat e autoritetit kompetent

1. Autoriteti kompetent i Ministrisë ka detyrat dhe autorizimet si në vijim:
 - 1.1. koordinimin ndërministror për punën dhe bashkëpunimin që ka të bëjë me autorizimin e PMB;
 - 1.2. kryerjen e procedurës për autorizim e PMB dhe lëshimi i lejes për vendosjen në treg dhe përdorim të tyre;
 - 1.3. mbajtjen e shënimeve, regjistrave dhe listave;
 - 1.4. monitorimin e vendosjes në treg dhe përdorimi i PMB dhe bashkëpunimi në përgatitjen e masave të nevojshme sipas këtij ligji;
 - 1.5. koordinimin e punës për harmonizimin e niveleve maksimale të mbetjeve për PMB dhe monitorimin e zbatimit të vlerësimit të niveleve maksimale të mbetjeve të tyre;
 - 1.6. hartimin e raporteve, analizave, informacioneve dhe materialeve tjera për organet dhe organizatat ndërkombëtare për të cilën Kosova nuk e ka të kufizuar të raportoj sipas këtij ligji;
 - 1.7. bashkëpunimin me organet tjera brenda dhe jashtë vendit në lëmin e vendosjes në treg dhe përdorimin e pesticideve;
 - 1.8. kryerjen e detyrave dhe punëve tjera shtesë.
2. Organi kompetent i Ministrisë, ka detyrat dhe autorizimet si në vijim:
 - 2.1. asistimin në përgatitjen e akteve nënligjore dhe monitorimi i zbatimit të ligjit;
 - 2.2. krijimin e kushteve për përmbushjen e detyrimeve për futjen në regjistër siç është e përcaktuar në nenin 29 të këtij Ligji;
 - 2.3. miratimin dhe monitorimin e programeve lidhur me masat për përdorimin e duhur të PMB;
 - 2.4. organizimin e aftësisë për zbatimin e praktikave të mira bujqësore dhe menaxhimin e integruar të organizmave dëmtues;
 - 2.5. përgatitjen e publikimeve nga kjo lëmi;
 - 2.6. mbikëqyrjen e sistemit informues në lëmin për grumbullimin, përpunimin, ndërhyrjen dhe ruajtjen e të dhënave, menaxhimin e sistemit informues;
 - 2.7. kryerjen e detyrave dhe punëve të tjera administrative.

Neni 50

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij Ligji dhe akteve nënligjore të nxjerr në bazë të tij e kryejnë Inspektorët e autorizuar të Ministrisë.
2. Inspektorët e autorizuar të Ministrisë të paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni kryejnë edhe punë tjera në lëmin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe sipas autorizimeve të parapara në Ligjin për inspektionin bujqësor.

Neni 51

Autorizimet e inspektoratit fitosanitar dhe të bujqësisë

1. Sipas ligjeve në fuqi, inspektorati fitosanitar dhe i bujqësisë do të:
 - 1.1. ndalon vendosjen në treg të PMB të pa autorizuar;
 - 1.2. ndalon përdorimin e PMB nëse nuk është lëshuar leja e importit dhe tregtimit;
 - 1.3. ndalon vendosjen në treg të PMB, të cilat nuk kanë afat të përdorimit,
 - 1.4. kontrollon përmbushjen e kushteve në lidhje me personelin e personave juridik apo fizik siç është e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 1 të këtij ligji;
 - 1.5. informon organin kompetent në lidhje me mungesën e personelit sipas nenit 5 dhe 9 të këtij ligji dhe ndalon aktivitetin e personave fizik apo juridik, përderisa të përmbushen kërkesat sipas këtij ligji;
 - 1.6. ndalon plasmanin në treg të PMB, nëse ato nuk janë në pajtim me autorizimin, paketimin, etiketimin, klasifikimin, lejet, udhëzimet për përdorim, përbërjet kimike ;
 - 1.7. ndalon përdorimin e PMB, nëse ato përdoren në mënyrë jo të duhur;
 - 1.8. urdhëron masa të duhura nëse vlerësohet që niveli maksimal i mbetjeve të PMB në bimë apo produkte me origjinë bimore është i pa pranueshëm, por këto masa merren para vendosjes së tyre në treg;
 - 1.9. merr mostrat e bimëve, produkteve bimore, tokës, përzierjeve të PMB në pajisjet për spërkatje, PMB dhe mostra të tjera të nevojshme;
 - 1.10. largon pajisjet për aplikimin e PMB nga tregu dhe urdhëron verifikimin e pëlqimit dhe certifikatës;
 - 1.11. ndalon vendosjen në treg të pajisjeve për aplikimin e PMB, nëse nuk është i pajisur dhe në pajtim me certifikatën;
 - 1.12. ndalon përdorimin e pajisjes për aplikim të PMB, nëse nuk është i pajisur me vulën për inspektimin e rregullt apo nëse nuk është i inspektuar rregullisht;
 - 1.13. vërteton nëse kryesit e shërbimeve në lëmin e PMB sipas këtij ligji përmbushin kushtet e veçanta apo kryen aktivitete tjera, dhe urdhëron masa tjera të domosdoshëm për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore;
 - 1.14. ndalon vendosjen në treg të bimëve apo produkteve bimore nga të cilat janë marr mostrat për vlerësimin e vlerave maksimale të mbetjeve të PMB, gjersa rezultatet e analizave të mostrave të tilla të përfundojnë.

Neni 52
Autorizimet e inspektorëve fitosanitar në kufi

1. Inspektorët fitosanitar kanë autorizimet si në vijim:
 - 1.1. kontrollojnë importimin e PMB në vendkalimet e përcaktuara kufitare, verifikojnë pëlqimin e punës apo veprimit të sigurt në pajtim me këtë ligj dhe akteve nënligjore;
 - 1.2. ndalojnë importin e PMB, nëse ato nuk janë autorizuar, klasifikuar, paketuar dhe pajisura me udhëzimet për përdorim;
 - 1.3. ndalojnë importin e PMB që nuk kanë leje përkatëse, apo nëse vendosja në treg e tyre është e ndaluar;

- 1.4. ndalojnë përkohësisht importin e PMB, nëse nuk janë të plotësuara dokumentacionet e nevojshme përcjellëse, deri sa ato të kompletohen;
- 1.5. kryejnë aktivitete të tjera dhe urdhërojnë masat në lidhje me PMB në pajtim me këtë ligj.

Neni 53 **Marrja dhe përdorimi i të dhënave**

1. Rregullimin e vendosjes në treg kontrollimin dhe përdorimin e PMB, autoriteti kompetent duhet që për bazën e të dhënave, të marrin dhe të përdorin të dhëna të cilat mbahen nga organet kompetente, institutet publike, agjencitë dhe organe tjera të autorizuara brenda kornizës së bazave të dhënave të kontraktuara, veçanërisht nga:

- 1.1. bazat e të dhënave nga fusha e PMB;
- 1.2. bazat e të dhënave për ndotjen e tokës dhe ujit;
- 1.3. bazat e të dhënave për ujërat dhe lëmit me rëndësi ekologjike;
- 1.4. kadastra dhe libri i tokave;
- 1.5. të dhëna themelore nga regjistri i popullatës, sa i përket pronarit apo përdoruesit.

2. Në pajtim me funksionet e tij, autoriteti kompetent, krijon lidhjet me të gjitha bazat e të dhënave të ministrive përkatëse.

3. Autoriteti kompetent duhet të bashkëpunojë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të autorizuar për mbledhjen e të dhënave për helmimet akute dhe efektet tjera nga PMB, si dhe të njëjtat të dhëna duhet prezantuar nëse është e nevojshme organizatave të tjera të autorizuara dhe bartëse të shërbimeve publike.

4. Të dhëna tjera që janë çështje konfidenciale sipas këtij ligji apo përdorimi i tyre është i kufizuar.

5. Bazat e të dhënave të cekura sipas paragrafit 1-4 të këtij neni komunikohen sipas Ligjit për qasje në dokumente zyrtare,

6. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë tjera përkatëse rregullon mënyrat e lidhjes me bazat e tjera të dhënave dhe mënyra e nxjerrjes së të dhënave në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 54 **Shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave**

1. Autoriteti kompetent dhe organi kompetent njoftojnë vendet tjera, nëse kërkohet nga Komisioni Evropian si dhe vendet anëtare të BE-së për:

- 1.1. efektet me rrezik potencial të ndonjë PMB sipas nenit 28 të këtij ligji;
- 1.2. autorizimet e përkohshme të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji;
- 1.3. vërtetimin e përkohshëm për nivelet maksimale të mbetjeve për PMB, nëse ende nuk janë të plotfuqishme ligjet dhe aktet nënligjore dhe të dhënat për vlerësimin e tyre;
- 1.4. lejet e veçanta të lëshuara sipas nenit 33 të këtij ligji;
- 1.5. vendimet lidhur me autorizimin dhe dërgimi e të dhënave, vendeve anëtare të BE-së, sipas kërkesës së tyre;
- 1.6. rezultatet e testeve dhe analizave shtesë të kërkuara në procedurën e autorizimit, lidhur me kërkesat për njohjen e autorizimeve nga vendet anëtare të BE-së sipas nenit 27 të këtij ligji;

- 1.7. vendimet për ekuivalencën e substancave aktive të prodhueseve, të përfshira në listën që i referohet nenit 27 së bashku me të dhënat për ekuivalencën dhe papastërtinë e substancave aktive sipas nenit 31 të këtij ligji;
- 1.8. rrezikshmërinë dhe shenjat e sigurisë për PMB dhe masat e përcaktuara në nenin 6 dhe 11 të këtij ligji;
- 1.9. rezultatet e inspektimit të PMB në treg dhe atyre në përdorim, që ofrohen deri më 10 shtator të vitit aktual për periudhën e vitit të kaluar;
- 1.10. të dhënat për PMB e autorizuara, të ndaluara, skadimin e autorizimit, kufizimet për përdorimin apo pezullimin e autorizimeve, si dhe të dhënat të tjera, për periudhë tremujore.
- 1.11 të dhënat përmbajnë së paku emrin e mbajtësit të autorizimit, emrin tregtar të PMB, llojin e preparatit ose formulimit, emrin dhe përmbajtjen e të gjitha substancave aktive, qëllimin e përdorimit, nivelin maksimal të mbetjeve të përkohshme, nëse nuk parashihet me nenin 10 të këtij Ligji dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e tyre;
- 1.12 listën e PMB të autorizuara në Kosovë, që jepet vetëm një herë në vit.

KREU IX

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 55

1. Me gjobë prej një mijë (1.000) € deri në pesë mijë (5.000) € për kundërvajtje dënohet personi fizik dhe juridik nëse:
 - 1.1. vepron në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji,
 - 1.2. nuk mbanë shënime sipas nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij ligji,
 - 1.3. vendos në treg PMB të klasifikuara në grupin e helmeve të rrezikshme T+ pa autorizim të Ministrisë,
 - 1.4. përdor PMB për qëllime hulumentimi pa lejen paraprake të Ministrisë, sipas nenit 32 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji,
 - 1.5. vendos në treg PMB në kundërshtim me nenin 35 paragraf 1 dhe 6 të këtij ligji dhe
 - 1.6. përdorë pajisjet për aplikimin e PMB pa shenjën dhe vulën e inspektimit të rregullt sipas nenit 44 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji.
2. Me gjobë prej dy mijë (2.000) € deri në pesë mijë (5.000) € për kundërvajtje dënohet personi fizik nëse:
 - 2.1. vendos në treg PMB me afat të skaduar dhe që është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 të këtij ligji,
 - 2.2. vepron në kundërshtim me nenin 28 të këtij ligji,
 - 2.3. nuk përmbush kushtet për përdorim dhe aplikim të PMB sipas nenit 41 paragrafi 1 të këtij ligji,
 - 2.4. nëse pengon inspektimin sipas nenit 51 pika 1.9, 1.10, 1.12, të këtij ligji.
3. Me gjobë prej dhjetë mijë (10.000) € deri në tridhjetë mijë (30.000) € për kundërvajtje dënohet personi juridik nëse:
 - 3.1. vendos në treg PMB me afat të skaduar dhe që është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 të këtij ligji,

- 3.2. vepron në kundërshtim me nenin 28 të këtij ligji,
- 3.3. nuk përmbush kushtet për përdorim dhe aplikim të PMB sipas nenit 41 paragrafi 1 të këtij ligji,
- 3.4. nëse pengon inspektimin sipas nenit 51 pika 1.9, 1.10, 1.12, të këtij ligji.
- 3.5. vendos në treg PMB të pa autorizuar nga Ministria dhe që është në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 1 të këtij ligji dhe
- 3.6. vepron në kundërshtim me nenin 42 paragrafi 3 i këtij ligji.

Neni 56

Pagesat që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe të hyrat tjera nga taksat derdhën në Buxhetin e Kosovës.

KREU X

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 57

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria, në afat prej tri (3) vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet ti nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 58

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon së vepruari Ligji Nr.2003/20 për pesticide i dt. 8 dhjetor 2003, si dhe çdo akt tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 59

Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-042

7 Nëntor 2008

**Shpallur me dekretin Nr. DL- 061- 2008, datë 27.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.**